



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 12.10.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/ L-040 dhe konfirmimin elektronik nga ana e Bordit të Drejtorëve të dt: 04.09.2015, me të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për formimin e Komisionit Komunal për Monitorimin dhe Vlerësimin e Zbatimit të Projektit të Zyrës për Mbështetje të Bizneseve (BDCO), me dt: 12.10.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Komunal për Monitorimin dhe Vlerësimin e Zbatimit të Projektit të Zyrës për Mbështetje të Bizneseve (BDCO), në këtë përbërje:

1. Burim Emra, kryesues i Komisionit
2. Bekim Syla, anëtar
3. Kelmend Vula, anëtar

2. Komisioni i përshkruar në pikën paraprake duhet të angazhohet për kryerjen e veprimeve si në vijim:

- Komisioni do të punon nga dita e fillimit të aktiviteteve deri tek pranimi final i zbatuesit të projektit, ku monitoron aktivitetet të cilat parashihen të mbulohen nga subvencionet e komunës, respektivisht Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik;
- Të verifikon Shpenzimet në bazë të planit financiar dhe faturave të realizuara;
- Të bënë evaluimin e rezultateve të arritura në bazë të planit të prezantuar në Komunë, respektivisht në DZHE;
- Komisioni jep vlerësimin dhe nënshkruan rregullsinë e faturave për inkasim , respektivisht reinbursimin e tyre nga ana e Komunës;
- Komisioni i monitorimit e plotëson dokumentin e monitorimit dhe e dorëzon në DZHE në përfundim të kohëzgjatjes së projektit;

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila